

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrja Publike Banësore me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.K juriste nga Pr., kundër të paditurit “A.O M.” me seli në Pr., me përfaqësues ligjor V.T, Rruga “U.”-“M.K” C..., H..., Nr..., me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 2,842.16 euro, në seancën e mbajtur më datë 14.03.2017, në prani të autorizuarës së paditësit dhe në mungesë përfaqësuesit ligjor të të paditurit, ndërsa me datë 17.03.2017 merr këtë;

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ndërmarrja Publike Banësore me seli në P..

I.DETYROHET pala e paditur “A.-O.M.” me seli në Prishtinë, me përfaqësues ligjor V.T, që paditësit në emër të borxhit të qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist, i cili gjendet në adresën “L.” Nr. ..., në Prishtinë, për periudhën kohore prej 05.01.2007 deri me 05.04.2007, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 2,842.16 euro (dymijë e tetëqind e katërmbëdhjetë e dy euro e gjashtëmbëdhjetë cent), me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 31.05.2007, e deri në pagesën definitive, në afat paritiv prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET i padituri që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 25.00 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve pas marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja Ndërmarrja Publike Banësore me seli në P., ka paraqitur padi me datë 31.05.2007 pranë Gjykatës Komonale në Prishtinë, kundër të paditurit “A.-O. M.” me seli në P., me përfaqësues ligjor V.T, duke kërkuar që t’ia paguaj në emër të qirasë të papaguar borxhin në shumën të përgjithshme prej 2,842.16 euro, me kamat ligjore duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, me propozim që pas administrimit të të gjitha provave padinë ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Lidhur me këtë çështje juridike Gjykata duke u bazuar në nenin 423 par. 4 të LPK-së, mbajti seancën kryesore, në mungesë të paditurit, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt me çka u vërtetua nga fletë kthesa, e cila gjendet në shkresat e lëndës, por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

E autorizuara e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar që të detyrohet i padituri “A.-O. M.” me seli në P., me përfaqësues ligjor V.T, që paditësit ti paguajë borxhin në emër të qirasë për lokalit e shfrytëzuar i cili gjendet në lagjen L. Nr..., në P., në shumën e përgjithshme prej 2,842.16 euro, për periudhën prej datës 01.01.2007 deri me datën 05.04.2007, duke përfshirë edhe TVSH-në prej 15%, si dhe kamatën ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankë nga dita e

paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive. Me propozim për gjykatën që pas administrimit të provave padinë ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor të kësaj çështje juridike për të vërtetuar gjendjen faktike juridike ka administruar këto prova dhe atë duke filluar nga: Kontrata me nr. 03-25/1 e datës 05.01.2007, pranimi i lokalit e datës 07.05.2007, procesverbali i datës 22.12.2006, kërkesa e datës 20.12.2006, kërkesa e datës 07.05.2007, vendimi i datës 02.07.2007, fatura e muajit janar 2007, shkurt 2007, mars 2007, prill 2007, analitika e qiramarrësit e datës 08.07.2016 me nr. 32/07.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të administruara dhe prezantuara nga palët ndërgjyqëse, gjykata i vlerësoi të gjitha, veç e veç dhe në varësi me njëra tjetrën në vështrim të nenit 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës dhe gjeti se:

Se në mes paditëses dhe të paditurit me datën 05.01.2007, është lidhur kontratë për dhënien me qira të lokalit me seli në P. në lagjen “L.” me nr...., me sipërfaqe 116.53 m², e cili i takon zonës 03, të kategorisë 01, kontrata është e lidhur për kohë të caktuar dhe atë në periudhën prej datës 01.01.2007 deri me datën 31.12.2007, e cila është shkëputur me datë 05.04.2007. Në kontratën e lartë cekur më konkretisht në nenin 1 përveç të tjerash ka paraparë se qiraja mujore për 1m² është në shumë prej 5.60 euro gjithsej qiraja për një muaj është 652.57 euro. Në këtë kontratë përveç të tjerash në nenin 6.6 kanë paraparë se qiradhënësi është i obliguar që për çdo muaj t’ia dërgoj faturën qiramarrësit, ndërsa në nenin 6.7 të kontratës në fjalë është paraparë që asnjë pagesë me para të gatshme nuk do të pranohet .

Nga procesverbali mbi pranimin e lokalit-dorëzimi me nr.19/4 dt.07.05.2007 vërtetohet fakti se i padituri e ka dorëzuar lokalin, i cili edhe është i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i të paditurit V.T dhe nga komisioni i paditëses.

Nga faturat me nr. 546-01/07, fatura me nr. 546-02/07, fatura me nr. 546-03/07, fatura me nr. 546-04/07, vërtetohet se paditësi ka tentuar t’ia dorëzoj të paditurit fatura me të cilën i janë lënë në derën e lokalit të të paditurit dorëzim ky jo i rregullt siç parashihet me kontratë përkatësisht siç parashihet me nenin 6 të së njëjtës kontratë, mirëpo i padituri nuk e ka mohuar borxhin sa i përket shfrytëzimit të lokalit me nr. 19/4, kjo vërtetohet nga procesverbali mbi dorëzimin e lokalit i datës 07.05.2007, ku është cekur nga i padituri se të gjitha shpenzimet që janë krijuar prej momentit të marrjes së lokalit e deri me sot i pranoj të gjitha, andaj është evidente se shpenzime janë edhe borxhi i krijuar në emër të qirasë, procesverbal ky i nënshkruar nga i padituri.

Nga provat e administruara si më sipër, rezulton se paditësi ka provuar faktin se ka pasur kontratë me shkrim të lidhur me të paditurin dhe atë për qiranë e lokalit me nr.19/4 me sipërfaqe prej 116.53 m². Kështu gjykata ka konstatuar se palët janë marrëveshë që periudha e qiras është nga data 01.01.2007 deri me datën 31.12.2007, e cila është shkëputur me datë 05.04.2007. Andaj, kjo periudhë kohore përfshinë 4 muaj qira.

Gjykata ka konstatuar se qiraja mujore për lokalit me nr.19/4 me sipërfaqe prej 116.53 m² (116.53X5.60 euro=652.57). Ku shuma prej 652.57 euro në muaj shumëzohet me muaj të shfrytëzimit të lokalit nr.19/4 rezulton borxhi total duke përfshirë edhe TVSH-në, gjithsej shumën prej 2,842.16 euro.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 262 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave dhe kontratës për shfrytëzimin e lokalit i ka borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurin që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Gjykata duke iu referuar nenin 15 dhe 17 të LMD-së, të cilët parashohin se palët kontraktuese në marrëdhëniet detyrimore kontraktuese janë të obliguara ti kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontrata dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, andaj në bazë të këtyre dispozitave edhe sipas nenit 42 ---dhe 596---- të LMD-së, gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurit për pagesën e borxhit.

Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroi të paditurin që t'ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga parashtrimi i padisë.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke aprovuar shumën e përgjithshme prej 25.00 euro në emër të taksës për padi.

Andaj gjykata bazuar në dispozitat e neni 262, 42, 596 dhe nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

III.EK.nr. 28/2016 të dt. 17.03.2017

G j y q t a r j a

Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.